



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 486/10 prot.

Datë 04.03.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 345/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.03.2026 shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 293/2026, datë 23.02.2026 për procedurën e prokurimit publik “E hapur e thjeshtuar”, me objekt: “Blerje libra artistikë për nevojat e MEPJ-së ” që janë me domen publik”, me fond limit: 6,071,388.33 (gjashtë milion e shtatëdhjetë e një mijë e treqind e tetëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, me Nr. REF-75442-02-06-2026, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 19.02.2026 nga Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Filara Education” shpk, me NUIS M12117037V, Adresa: Rruga e Kavajës, Kompleksi Square 21, Shkalla 1, Apartamenti Nr. 29, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.  
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin

*e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 23.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 293/2026, ku vendosi:

“[...]

1. *Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Filara Education” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me objekt: “Blerje libra artistikë për nevojat e MEPJ-së ” që janë me domen publik”, me fond limit: 6,071,388.33 (gjashtë milion e shtatëdhjetë e një mijë e treqind e tetëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, me Nr. REF-75442-02-06-2026, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 19.02.2026 nga Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.*
2. *Autoriteti kontraktor, të kryejë modifikimet e DST sipas konstatimeve të KSHA për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Filara Education” SHPK.*
5. *Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë... [...]*”

I.2. Me shkresën nr. 325/10 prot., me objekt “Zbatim i vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me nr.293/2026”, protokolluar me tonën nr. 486/7 prot., datë 02.03.2026, autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a njofton se ka zbatuar vendimin Nr.293/2026, datë 23.02.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik duke i bashkëngjitur shkresës edhe shtojcën me modifikimet e dokumenteve të tenderit.

## II Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

### Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 325/10 prot., me objekt “Zbatim i vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me nr.293/2026”, protokolluar me tonën nr. 486/7 prot., datë 02.03.2026, autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a njofton se ka zbatuar vendimin Nr.293/2026, datë 23.02.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik duke i bashkëngjitur shkresës edhe shtojcën me modifikimet e dokumenteve të tenderit.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se shtojca është publikuar në SPE.

Nga verifikimet në shtojcën e dërguar nga autoriteti kontraktor dhe publikuar në SPE, konstatohet se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e KPP Nr. 293/2026, datë 23.02.2026.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a e ka zbatuar vendimin Nr. 293/2026, datë 23.02.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me objekt: “Blerje libra artistikë për nevojat e MEPJ-së ” që janë me domen publik”, me fond limit: 6,071,388.33 (gjashtë milion e shtatëdhjetë e një mijë e treqind e tetëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, me Nr. REF-75442-02-06-2026, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 19.02.2026 nga Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Gjergji Mersini**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

